

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**

SYLABUSET E LËNDËVE – Studimet Bachelor (Bsc)

1. Syllabuset për studimet BACHELOR (Bsc) - Drejtimi i Prodhimtarisë dhe automatizimit

Titulli i lëndës:	MATEMATIKË I		
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematica që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinjeri		
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga matematika të nevojshme për aplikimin në shkencën makinerisë		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri të ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i aparatit matematikor.</p> <p>Studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojnë bashkësitë numerike në shqyrtimet dhe prezantimin e kuptimeve tjera si nga algjebra ashtu edhe nga analiza matematike - të njoh kuptimin e matricës dhe përcaktorëve si dhe të vërtetoj vetitë e përcaktorëve të cilat zbatohen për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve - të zgjidh sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme - të njoh kuptimin e vektorit, veprimet si lineare ashtu edhe jo lineare me vektor si dhe të zbatoj vetitë e veprimeve me vektor në shkencat mekanikës teknike - të paraqes forma të ndryshme të ekuacionit të rrafshit të drejtëzës në hapësirë si dhe pozitat reciproke të tyre - të paraqes në formë gjeometrike dhe analitike format e sipërfaqeve në hapësirë 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	7	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		Pjesa praktike (%)
	50%		50%
Literatura bazë:	<p>1. Dr.Sadri Shkodra –Matematika I, Prishtinë, 2001</p> <p>2. Dr.Fevzi Berisha-Dr.Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë.</p> <p>3. Dr.Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006.</p>		

Titulli i lëndës:	GRAFIKA INXHINIERIKE		
Përshkrimi i lëndës	Njohuri me standardet teknike. Vizatimi teknik. Formatet, përpjesët, tabelat. Konstruktimi i objekteve gjeometrike. Shkrimi teknik. Dimensionimi dhe kuotimi. Rregullat e projektimit në vizatim teknik. Prerjet. Skicimi. Paraqitja e vizatimeve teknike. Gjeometria Deskriptive. Projektioni i elementeve gjeometrike. Prerjet e trupave. Ndërhyrjet e trupave. Problemet metrike. Paraqitja aksonometrike.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Inxhinierisë grafike		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Studentët do të përvetësojnë:</i> Shkronjat teknike, llojet e vijave, llojet e letres, formatet, tabelat. Vizatimin e konstrukcioneve gjeometrike. Skicimin. Rregullat e dimensionimit. Paraqitjen e pikave, vijave, objekteve dhe trupave të ndryshëm në hapsirë. Prerjen dhe ndërhyrjen e trupave. Vizatimin e objekteve dhe trupave në projektione. Krijimin e vizatimeve teknike dhe makinerike. Paraqitjen dhe leximin e vizatimeve.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	3	5	15
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	8	24
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Total			172
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Literatura bazë:	[1]Prof.dr. Musli Bajraktari, Dr.sc. Ilir Doçi, <i>Grafika inxhinierike</i> , Prishtinë, 2012. [2] K.C. John, <i>Engineering Graphics for Diploma</i> , PHI Learning Private Limited, 2009. [3] Dr.sc. Musli Bajraktari, <i>Gjeometri Deskriptive</i> , Prishtinë, 2004. [4] Hans Hoischen, <i>Technisches Zeichnen, Grundlagen, Normen, Beispiele Darstellende Geometrie</i> , Cornelsen, 2002. [5] Simmons C., Maguire D., Phelps N., <i>Manual of engineering drawing</i> , 2009 Elsevier Ltd.		

Titulli i lëndës:	FIZIKA		
Përshkrimi i lëndës	Njohuri mbi ligjet themelore të fizikes, Studimi i madhësive fizike dhe matja eksperimentale e tyre. Paraqitja e koncepteve të fizikës bashkohore si të fizikes atomike, molekulare bërthamore dhe te grimcave elementare. Studimi i koncepteve fizike të cilat gjejnë zbatim në lëmitë e inxhinierisë mekanike.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentit që të zgjedhë dhe zbaton metodën dhe përmbajtjen nga fizika, për nevoja ne procesin e prodhimit të lëmisë përkatëse teknike, që procesi teknologjik i prodhimit të ketë vlerë të lartë cilësore		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: të vlerësojë përdorimin e zbulimeve nga fizika, të cilat mundësojnë krijimin e ndonjë makine, aparature, instrumenti etj. të veçantë, që do të ishte shumë cilësor. Të përcaktohet për procesin, metodën, aparaturën, instrumentin, makinën etj. në të cilat bëhet zbatimi i të arriturave shkencore nga fizika, e cila është bazë për zhvillimin e teknikës. Të përcjellë dhe përcaktojë cilësinë e procesit teknologjik në teknikë, në bazë të njohurisë së fenomeneve, metodave, ligjeve, teorive etj., të cilat gjenden në lëndën e fizikës, në lëndët e teknikës dhe në lëndët tjera të shkencave natyrore. Më në fund, vet mud të sheh nga shumë shembuj, se ekziston lidhja reciproke e fizikës dhe teknikës, e nga kjo edhe rëndësinë e fizikës, si lëndë e cila zhvillohet në vitin e parë të studimeve në të gjitha fakultetet teknike		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Total			172
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		Pjesa praktike (%)
	50%		50%
Literatura bazë:	[1].Dr. Skender H. Skenderi & Dr. Rashit Maliqi, Fizika për studentët e fakulteteve teknike, Prishtinë, 2005. [2]. Dr. Skender H. Skenderi & Dr. Rashit Maliqi, Përmbledhje detyrash nga Fizika,. [3]. Dr. Skender H. Skenderi & Dr. Rashit Maliqi, Ushtrime interaktive dhe laboratorike nga Fizika, Prishtinë		

Titulli i lëndës: INFORMATIKË DHE PROGRAMIM			
Përshkrimi i lëndës	Njohuri bazike për përdorim të kompjuterit: sistemet operative, MS Office programi për përpunim të teksteve (Word), programi për llogaritje dhe shkrim të macrove (Excel) dhe programi për prezantime (PowerPoint). Njohuri themelore të përdorimit të softuerit MathCad në aspektin e problemeve matematikore si dhe ato komplekse: numrat kompleks, sistemet e ekuacioneve, vektorët, matricat, paraqitjet grafike të funksioneve, derivatet dhe integralet etj. Njohuri themelore të përdorimit dhe programimit në Matlab ose C++ me theks të veçantë tek vektorët dhe matricat, sistemet e ekuacioneve lineare dhe jolineare, paraqitje grafike, derivime dhe integrimi sipas skemave përkatëse. Krijimi dhe kompilimi i programeve për zgjidhje të problemeve të ndryshme matematikore.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me bazat themelore të punës me kompjuter si sistemet operative, MS Office programet për përpunim të teksteve, për llogaritje, shkrim të macrove dhe për prezantim etj. Njohja e studentëve me softuerët bashkëkohor që përdoren më së tepërmi në inxhinieri në përgjithësi si Mathcad dhe Matlab. Orientim të drejtë të studentit që të përvetësojë softuerët expert dhe të kohës (versionet update).		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri bazë dhe të rëndësishme për punë me kompjuter - Njohuri bazë dhe të rëndësishme në shfrytëzimin e softuerit MathCad - Njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe programimin në Matlab ose C++. - Do të kanë vlerësimet e tyre, të sigurta, aplikimet e këtyre softuerëve në kurset e ardhshme profesionale. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgatitja përfundimtare për provim	20	1	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet ,etj	0	0	0
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime etj.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë dhe i dytë intermediar: 2x20%; Vijimi i rregullt 10%; Provimi final 50%; Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	[1] Ligjërata të autorizuara nga profesori. [2] Ahmet Shala, Informatika dhe Programimi, Prishtinë 2013		
Literatura shtesë:	[1] Dr. sc. Ahmet Shala, Bazat e punës me kompjuter, Prishtinë, 2011 [2] User Guide for MathCad & Matlab updated version [3] Bjarne Stroustrup, The C++ Programming Language, 4th Edition, 2013		

Titulli i lëndës:		GJUHE ANGLEZE I	
Përshkrimi i lëndës	Gjuhë angleze-gjuhë e huaj. Temat që trajtohen gjatë vitit u ndihmojnë dhe i favorizojnë studentet që të mësojnë dhe të përdorin fjalorin profesional duke përvetësuar katër shkathësitë themelore të anglishtes: të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit dhe të folurit, gjegjësisht të komunikuarit në një nivel që i përshtatet njohurive, aftësive dhe nivelit të tyre studimor. Mësimi i gjuhës angleze në këtë drejtim, nuk ka për qëllim që të mësohen lëndet inxhinjerie në gjuhën angleze, por të implikohet gjuha angleze në lëndë, duke mësuar fjalë, shprehje profesionale, të ndërlidhura me gramatikën adekuate që trajtohet në temë.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi specifik i kësaj lënde është që studentët e këtij profili edukativo-arsimor të arrijnë atë nivel të njohurive gjuhësore dhe të një vokabulari të tillë që do të ishte i nevojshëm për punën e tyre në të ardhmen si dhe për avancimin e aftësive të tyre studimore për specializime të mëtutjeshëm në fusha të ngjashme profesionale		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje: 1. Të përdorin fjalor dhe literaturë profesionale 2. Të shpjegojnë tema të fushës së tyre 3. Të identifikojnë shprehjet shkencore në njësinë mësimore 4. Të krahasojnë dhe 5. Të vlerësojnë temat që janë zhvilluar gjatë procesit mësimor		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	7	14
Përgatitja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	3	6
Totali			112
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>metodat komunikative, leksike, eklektike</i>		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa praktike (%)</i>
	50%		50%
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dobrila Nastic, Vera Vuckovic-Kosovac : Engleski Jezik za elektrotehnicke i masinske fakultete, Sarajevo 2. Lindsay White, Engineering – OUP 3. Peter Astley & Lewis Lansford; Oxford English for Careers: Engineering 1 		

Titulli i lëndës:		GJUHË GJERMANE I	
Përshkrimi i lëndës	<p>Në lëndën <i>Gjuhë gjermane I</i> gjatë ligjëratave do të mësohen pjesë nga gramatika e gjuhës gjermane që janë në shërbim të komunikimit dhe që janë të lidhura ngushtë me temat që do të trajtohen gjatë semestrit. Temat që do të zhvillohen do të jenë kryesisht nga libri bazë i kësaj lënde “<i>Themen Aktuell I</i>” leksionet 1-5.</p> <p>Gjatë ushtrimeve do të ushtrohen dhe do të zhvillohen sistematikisht katër shkathtësitë kryesore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, por edhe gramatika e fjalori (vokabulari) përmes temave të librit “<i>Themen Aktuell I</i>”. Ky libër është i ndarë në leksione të cilat janë të organizuara në mënyrë tematike. Temat janë të zgjedhura nga jeta e përditshme dhe përkohë me interesimet e nxënësve fillestarë. Përmes këtyre temave thellohen njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese në komunikimin e përditshëm. Studentët mësojnë si të reagojnë në situata të ndryshme komunikative me njerëz, për profesionet e tyre, për nevojat themelore jetësore, etj. Për të ushtruar shkathtësinë e të dëgjuarit, gjatë ushtrimeve do të përdoren edhe CD-të me tema nga libri bazë.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda “<i>Gjuhë Gjermane I</i>” ka për qëllim të ushtruarit e shkathtësive gjuhësore, të cilat i shërbejnë studentëve për të komunikuar në gjuhën gjermane, për të lexuar, por, edhe për të shkruar tekste të shkurtëra, mundësisht pa gabime.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë tekste të ndryshme shumë të shkurtëra mundësisht duke iu përmbajtur rregullave të drejtshkrimit dhe të strukturës së fjalisë së gjuhës gjermane • të lexojë drejtë duke ju përmbajtur rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës gjermane si dhe të kuptojë tekstet e lexuara • të dëgjojë dhe të kuptojë biseda e tekste të caktuara, por të thjeshta në gjuhën gjermane • të mësojë fjalët e vokabularit që është përdorur në librin “<i>Themen Aktuell 1</i>” • të dijë gramatikën e shpjeguar në librin “<i>Themen Aktuell 1</i>”, e cila është në shërbim të komunikimit • të aftësohen të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorimin më të vetëdijshëm të gjuhës amtare, që t’i zhvillojnë në mënyrë të pavarur më tutje aftësitë e fituara në gjuhën gjermane si dhe mbi këtë bazë të mësojnë gjuhë të tjera të huaja. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min.	15	4
Kollokfiume,seminare	15	1	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	2	1	2
Totali			123 orë: 25 = 4.92 5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Lënda realizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese – punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Duke qenë se metodat më të reja të mësimdhënies së gjuhëve të huaja thonë se mënyra më e mirë e mësimin të gjuhëve të huaja bëhet përmes komunikimit, kështu edhe zhvillohen orët. Në të njëjtën formë është i konceptuar edhe libri me të cilin kam zgjedhur të punojmë. Pra, mënyra e mësimdhënies është ajo me studentin në qendër me ç’rast ata janë tërë kohën të angazhuar dhe të kyqur në bashkëbisedë. Në orët e</p>		

	ushtrimeve punohet me libër tjetër të veçantë ku njohuritë e marra nga ligjëratat, studentët i përsërisin me shkrim dhe njëkohësisht i bëjnë edhe ushtrimet gramatikore.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Testi gjysëmsemestral 35% • Testi final 50% • Detyrat dhe aktiviteti në klasë gjatë semestrit 8% • Pjesëmarrja 7%
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. „<i>Themen Aktuell 1</i>”, Kursbuch, Lektion 1-5, Hueber Verlag, München, 2007 2. “<i>Themen Aktuell 1</i>”, Arbeitsbuch, Lektion 1-5, Hueber Verlag, München, 2007
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dreyer-Schmitt: <i>Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik (Neubearbeitung)</i>- Verlag für Deutsch 2. <i>Unterwegs</i>, Band: 5, Ernst Klett Schulbuchverlag, Stuttgart, 2001

Titulli i lëndës:	GJUHË FRENGE 1		
Përshkrimi i lëndës	Përvetësimi i një fjalori dhe i nocioneve gramatikore themelore, që japin mundësi të përdoren automatizma të nevojshme në praktikën e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar: zotrimi efektiv i gjuhës që çdo ditë e më shumë e kërkojnë nevojat e profesionit dhe të punës shkencore . Njohja e jetës së qytetimit të popullit freng. Zhvillim i aftësive të studentëve për të njohur sa më mirë historinë dhe kulturën e këtij populli.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve për të komunikuar dhe shkruar në këtë gjuhë		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Rezultatet të pritura të nxënies (nënkuptojnë njohuri, aftësi dhe shkathësitë që do t'i fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi. Për ti paraqitur këto të arritura përdoren foljet si: din, njeh, përshkruan, krahason, projektton, harton, zhvillon,etj.). Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. <u>Të komunikoj, të din dhe njeh gjuhën frenge</u> 2. <u>Të jetë në gjendje të shkruaj për nivelin e parë dhe të dytë</u> 3. <u>Të bëj përshkrimin e leksionit, të hartoj një ese të shkurtër, të bëj krahasime në mes të gjuhës frenge dhe shqipe.</u> Metodologjia e mësimdhënies: (p.sh. ligjërata, seminar, diskutim, punë në grupe, etj.)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 minuta	15	2.5
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	-	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1	1
Projektet,prezentimet ,etj	5	1	5
Total			148.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodat e kombinuara audio-orale etj.- Ligjërata, ushtrime , detyra, shembuj konkret, teste, diskutime etj		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		Pjesa praktike (%)
	30%		70%
Literatura bazë:	Grup autorësh Nassia – Kaneman – Paugatch Sandra- Trevisi, Dominique Jennepin, “Café Crème I (Méthode de français), Hachete, Livre français étrangère, 58, rue Jean Bleuze 9317 Vanves.		

Titulli i lëndës:	MATEMATIKË II		
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematikë që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinieri		
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga matematikë të nevojshme për aplikimin në shkencën e makinerisë		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor.</p> <p>Studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë vargje kur janë dhënë kufizat e përgjithshme të tyre - të zbatoi vetitë e vargut aritmetik dhe gjeometrik në zgjidhjen e problemeve të ndryshme - të paraqes grafikisht funksionet themelore elementare - të zbatoi limitin e funksionit për të përcaktuar vazhdueshmërinë e funksionit - të nxjerr derivatin e funksioneve elementare dhe në bazë të vetive të derivatit të gjejë derivatin e secilit funksion, - duke u bazuar në derivatin e funksionit të shqyrtoi dhe të paraqes grafikisht funksionet - të gjejë integralin e pacaktuar për disa klasa të funksioneve - të zbatoi integralin e caktuar në zgjidhjen e disa problemeve nga gjeometria dhe mekanika 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	7	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		Pjesa praktike (%)
	50%		50%
Literatura bazë:	1. Dr. Sadri Shkodra –Matematika I, Prishtinë, 2001 2. Dr.Fevzi Berisha-Dr.Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë. 3. Dr.Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006.		

Titulli i lëndës:	STATIKA		
Përshkrimi i lëndës	Kuptimet themelore. Definicionet, aksiomet-postulatet dhe lidhjet. Sistemi i forcave që priten në një pikë-tufa e forcave. Sistemi i forcave në rrafsh-komplanare. Elementete statike grafike. Ekuilibri i trupit të ngurtë në rrafsh dhe diagramet statike. Ekuilibri i sistemit të trupave të ngurtë në rrafsh. Mbajtësit kapriatë. Fërkimi. Sistemi i forcave të çfarëdoshme në hapësirë. Ekuilibri i trupit të ngurtë në hapësirë. Qendra e rëndesës-gravitetit.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmi Inxhinierisë mekanike- Statikës.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Studentët do të përvetësojnë:</i></p> <p>A. Të gjejë rezultanten e dy e me shumë forcave të cilat veprojnë në një pikë, në rastin kur ato forca janë kolineare (në një vijë), plane (rrafshore) apo hapësinore.</p> <p>B. Studenti duhet të dijë të zbërthejë forcën në dy apo tri drejtime të dhëna plane.</p> <p>C. Të dijë të gjejë rezultanten e sistemit të forcave të çfarëdoshme në plan.</p> <p>D. Të llogaris reaksionet e një trupi apo sistem trupash në rrafsh në rastin e ekuilibrit kur fërkimi nuk përfillet si edhe kur ai përfillet.</p> <p>E. Për mbajtësit e ngarkuar: tra i thjeshtë, tra i Gerberit, ram i thjeshtë dhe ram i Gerberit të dijë ti gjejë reaksionet dhe të dijë ti llogarisë dhe vizatoi diagramet statike: M,T dhe N.</p> <p>G. Për mbajtësin kapriatë të dhënë, të dijë ti gjejë reaksionet, ti llogarisë forcat në shufra të kapriatës me metodën e ekuilibrit të njejeve. Me metodën analitike të ekuilibrit të prerjes të dijë ti llogarisë forcat në shufrat e prera në mënyrë analitike dhe grafike.</p> <p>G. Për një trup (bosht, pllakë, etj.) të përforcuar dhe ngarkuar me ngarkesa hapësinore, të dijë ti gjejë reaksionet e lidhjeve, për rastin e ekuilibrit.</p> <p>F. Të dijë të gjejë qendrën e rëndesës (gravitetit) për trupa: të përbërë prej trupave të thjeshtë: 1D, 2D dhe 3D. Të dijë të gjejë syprinën e sipërfaqes kur një vijë rrotullohet rreth aksit x apo y. Të dijë të gjejë vëllimin kur një sipërfaqe rrotullohet rreth aksit x apo y.</p> <p>H. Ti zgjidhë dhe dorëzoi dy detyra seminarike duke përdorur programin aplikativ MathCAD në zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve që do të shërbejë si kontroll i rezultateve. Ti zgjidhë dhe dorëzoi duke i mbrojtur ato para asistentit 2 detyra grafike, duke përdorur programin aplikativ IQ100 në kontrollimin e rezultateve: reaksioneve dhe diagrameve statike.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume, seminare, detyra grafike	4	4	16
Detyra të shtëpisë	4	9	36
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis, provim final)	2	3	6

Projektet, prezantimet ,etj	1	1	1
Total			169
Metodologjia e mësimeve:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, punime grafike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Literatura bazë:	<p>[1]. Dr. sc. Thanas Gace-Dr. sc. Fehmi Krasniqi : Statika -Ligjërata të autorizuara, Prishtinë/Tiranë.</p> <p>[2]. Dr. sc. Fehmi Krasniqi - Ing. i dipl. Gani Bajrami: Statika - Përmbledhje detyrash grafike të zgjidhura, Prishtinë.</p> <p>[3]. Dr. sc. Fehmi Krasniqi - Dr. sc. Ahmet Shala : Statika - Përmbledhje detyrash seminarike, Prishtinë.</p> <p>[4]. Dr. sc. Fehmi Krasniqi: Statika - Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë..</p> <p>[5]. Dr. sc. Fehmi Krasniqi: Statika - Përmbledhje detyrash të provimeve të zgjidhura, Prishtinë..</p> <p>[6]. Dr. sc. Fetah Jagxhiu : Mekanika pjesa I/Statika, Prishtinë.</p> <p>[7]. Dr. sc. Fetah Jagxhiu: Mekanika I/Statika- Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë.</p> <p>[8]. Dr. sc. Fehmi Krasniqi- Dr. sc. Ahmet Shala: Statika-Përdorimi i softuerëve MathCad dhe IQ100 në zgjidhjen e detyrave të statikës, Prishtinë.</p>		

Titulli i lëndës:	VIZATIMI ME KOMPJUTER		
Përshkrimi i lëndës	Qëllimi i kursit është njohja dhe aftësimi i studentëve (vijuesve) me parimet themelore dhe të avancuara të vizatimit teknik duke shfrytëzuar softuerin e mirënjohur aplikativ të kësaj lëmie – AutoCAD. Atë që vijuesi e ka fituar në vizatimin teknik, përmes shfrytëzimit të softuerit do ta zbatojë në mënyrë shumë më moderne dhe do ta zbatoj në lëndët në vijim të studimeve.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia Vizatimi me kompjuter		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Studentët do të përvetësojnë:</i></p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të zbatojë metodat bashkëkohore të vizatimit në problemet që do ti paraqiten në të ardhmen si në lëndët në vijim të studimeve po ashtu edhe në punën e tij profesionale. 2. Të shfrytëzojë dhe zbatojë njohuritë nga softuerët përkatës (versionet e reja të tij). 3. Të zhvilloj dhe me sukses ti përfundoj projektet e ndryshme profesionale me zbatimin e kompjuterëve dhe softuerëve aplikativ. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsëj
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	8	5	40
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	10	20
Ushtrime në teren	6	6	36
Kollokuiume, seminare	8	1	16
Detyra të shtëpisë	3	9	27
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	6	1	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	8	2	16
Total			245
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia që do të përdoret është metodologji e bazuar me studentin në qendër. Ligjëratat (vite me radhë janë mbajtur) mbahen me ndihmën e projektorit duke e shfrytëzuar softuerin drejtpërdrejtë në procesin e ligjëratave. Pas ligjëratave studentët motivohen për shtruarjen e pyetjeve dhe për diskutime rreth problemeve të panjohura që ceken në ligjëratën përkatëse, me qëllim të rritjes së invencionit dhe mendimit kritik të studentëve.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	60%		40%
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sadullah Avdiu; <i>Vizatimi me kompjuter - ribotim</i>, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, 2008. 2. Sadullah Avdiu; <i>Vizatimi me kompjuter – Praktikum</i>, botimi i katër, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, 2012. 3. Milan Opalić, Milan Kljajin, Slavko Sebastijanović: <i>Tehničko crtanje</i>, Zagreb/ Slavonski Brod, 2002. 		

Titulli i lëndës:	MATERIALET MEKANIKE		
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë do të jepen materialet që përdoren në mekatronikë. Ndarja e materialeve, karakteristikat e tyre, përfitimi dhe përpunimi, përdorimi dhe zgjedhja e materialeve, etj.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me materialet mekanike dhe që përdoren në inxhinieri mekanike, përkatësisht në prodhimtari, në energjetikë dhe konstruksione makinerike, duke filluar nga karakteristikat e materialeve, përpunimi e deri te përdorimi i tyre. Gjithashtu do të sqarohet edhe mënyra e zgjedhjes së materialeve përkatëse.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	T'i mësoj vetitë e materialeve mekanike; të bëjë dallimin në mes materialeve dhe ti vlerësoj ato; të bëjë zgjedhjen e materialeve në varësi nga lloji i konstruksionit dhe vendi i përdorimit 4. të jepë vlerësime për vetitë dhe veçoritë e tyre		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Ushtrime në teren	3	3	9
Kollokfiume,seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	1	7	7
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			155
Metodologjia e mësimdhënies:	ligjërata, seminar, diskutim, punë në grupe, etj.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 20% ; Vlerësimi i dytë 20% ; Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 15% ; Vijimi i rregullt 5% ;Provimi final 40% ; Total 100%		
Literatura bazë:	1.Prof.dr. Hysni Osmani, Materialet Mekanike, <i>Pjesa e parë</i> , FIM, Prishtinë 2014 2.Prof.dr. Hysni Osmani, Materialet Mekanike, <i>Pjesa e dytë</i> , FIM, Prishtinë 2014.		
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. William D. Callister, Jr. Materials Science and Engineering an Introduction, 8 ed. 2. William D. Callister, David G.Rethwisch Fundamentals of Materials Science and Engineering: An Integrated Approach, 3 ed. 3. Hysni Osmani, Materialet Mekanike – Provat e materialeve, 2004 4. Hysni Osmani, Bajrush Bytyqi, Materialet e Makinerisë – Ushtrime Laboratorike. 5. Mladen Franz, Mehanicka svojstva materijala, FSB, Zagreb, 1998. 6. Bashkim Baholli, I. Hoxha, G.Demiraj, E.Lamani, Struktura dhe përpunimi termik i metaleve, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Tiranë, 1986. 7. Heinrich Oettel, Herrmann Schumann, , Metallografie – 15 Auflage, WILEY-VCH Verlag GmBH&Co.KgaA, 2011. 8. Serope Kalpakjian, Steven R. Schmid, Manufacturing Engineering and Technology, 5th ed., 2006, by Pearson Education. 9. Serope Kalpakjian, Steven R. Schmid, Manufacturing Processes for Engineering Materials, 5th ed., 2006, by Pearson Education. 		

Titulli i lëndës:		SOFTUERËT APLIKATIVË	
Përshkrimi i lëndës	Njohuri themelore të përdorimit të softuerit MathCad në aspektin e problemeve matematikore si dhe ato komplekse: numrat kompleks, sistemet e ekuacioneve, vektorët, matricat, paraqitjet grafike të funksioneve, derivatet dhe integralet etj. Njohuri themelore të përdorimit dhe programimit në Matlab me theks të veçantë tek vektorët dhe matricat, sistemet e ekuacioneve lineare dhe jolineare, dhe në fund krimin e një modeli në Simulink për paraqitje grafike, derivime dhe integrame sipas skemave përkatëse. Konceptet themelore të Programimi i orientuar në Objekte - JAVA. Kuptimi i tekstit, konstanteve, variablave dhe të dhënave tjera në Java. Krijimi dhe kompilimi i file-t në Java për zgjidhje të problemeve të ndryshme matematikore. Shfrytëzimi i editorëve për programim në Java.		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me softuerët bashkëkohor që përdoren më së tepërmi në mekanikë në përgjithësi. Orientim të drejt të studentit që të përvetësojë expert softuerët aktual (versionet update). Materia që shtjellohet në këtë kurs paraqet vazhdimësi të përvojave të punës me kompjuter si dhe bazë të mirë për lehtësimin e përdorimit të softuerëve në studimet vijuese.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët pas përfundimit me sukses të modulit Softuerët aplikativë , do të kanë: Njohuri bazë dhe të rëndësishme në shfrytëzimin e softuerit MathCad; Njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe programimin në Matlab; Njohuri bazike për programim të orientuar në objekte – JAVA; Do të kanë vlerësimet e tyre, të sigurta, aplikimet kritike dhe kreative të këtyre softuerëve në kurset e ardhshme profesionale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	20	1	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet ,etj	0	0	0
Totali			140 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime etj.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Literatura			
Literatura bazë:	[3] Ligjërata të autorizuara nga profesori i lëndës. [4] Ahmet Shala, Software-t aplikativë, Prishtinë 2004-2012 [5] Lewis & Loftus; Java Software Solutions, Pearson Education, 2012		

Titulli i lëndës:	DETALET E MAKINAVE I		
Përshkrimi i lëndës	Njohja e studentëve me Detalet e makinave I të grupit të përgjithshëm që përdoren te të gjitha makinat dhe pajisjet. Materia që shtjellohet në këtë kurs paraqet bazën për lëndët tjera në vitet vijuese të departamenteve të veçanta.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia Detalet e Makinave I		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohja, aftësimi dhe aplikimi i njohurive të arritura në këtë kurs në të gjitha lëndët që në përmbajtjen e tyre përfshin makina, pajisje dhe stabilimente të ndryshme në ekonomi. Të arriturat e tyre i shprehin përmes projektimit dhe konstruktimit të pjesëve makinerike të grupit të përgjithshëm		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	4	1	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	3	9
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Total			169
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezenteve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa praktike (%)</i>
	50%		50%
Literatura bazë:	[1] Dr. sc. Nijazi Ibrahim, Detalet e Makinave I, Prishtinë 2012, [2] Dr. sc. Nijazi Ibrahim, Detalet e Makinave II, Prishtinë 2012, [3] Dr. sc. Nijazi Ibrahim, Detalet e Makinave I, II, Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë 2007. [4] Dr. sc. Nijazi Ibrahim, Vizatimi teknik, Prishtinë 2004.		

Titulli i lëndës:	MEKANIKA E FLUIDEVE		
Përshkrimi i lëndës	Njohuri për vetitë fizike të fluideve. Statikën e fluideve, Ligjet fizike të staikes së fluideve. Forca e presionit në sipërfaqet plane dhe kurbëzuar. Kinematika e fluideve. Dinamika e fluideve. Ekuacioni i Bernoullit. Regjimet e lëvizjes së lëngjeve. Humbjete e energjisë së lëngut gjatë lëvizjes. Rrjedhja e qëndrueshme e lëngjeve nëpër tuba. Goditja hidraulike nëpër tuba të thjeshtë, Rrjedhja e lëngut nëpër vrima, Veprimi dinamik i rrymave. Teoria e ngjajshmerisë dhe analiza dimensionale.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Mekanikës së fluideve		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Studentët do të përvetësojnë:</i> Ndikimin e presionit dhe temperatures në vetitë fizike të fluideve. Instrumentet matëse të presionit. Zbatimin e ligjit të Arkimit. Zbatimin e ekuacionit të Bernoullit. Karakteristikat e regjimit laminar dhe turbulent. Humbjet lokale dhe gjatësore gjatë rrymimit të fluidit. Shpejtësia e përhapjes së goditjes hidraulike dhe mënjanimi i goditjeve hidraulike. Llogaria hidraulike e hundëzave. Forca dinamike e rrymës. Kriteret e ngjajshmerisë gjeometrike, kinematike dhe dinamike.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Total			172
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Literatura bazë:	[1]Prof.dr. Januz Bunjaku, <i>Mekanika e fluideve</i> , Ligjeratat e autorizuar, Prishtinë, 2011. [2] Munson/Young/Okiishi <i>FUNDAMENTALS OF FLUID MECHANICS</i> , USA 2002 [3] Mr.inxh.XHEMAJL FEJZULLAHU, Dr.inxh.FEJZULLAH KRASNIQI, <i>HIDRAULIKA DHE TERMODINAMIKA</i> , Prishtinë, 1988.		

Titulli i lëndës:	REZISTENCA E MATERIALEVE		
Përshkrimi i lëndës	Njohuri të përgjithshme mbi lëndën, momentet e inercisë të seksioneve planare, pastaj, trajtimi i ndemjeve themelore- ndemjes aksiale, rrëshqitjes, përdredhjes, përkuljes si dhe atyre të përbëra-përkuljes së pjerrët, epjes, etj. Së fundi, shtjellohen metodat e energjisë së deformimit në zgjidhjen e problemeve të rezistencës së materialeve dhe sistemet statikisht të papërcaktuara në përkulje sipas metodës së punës së deformimit, metodës së Morit dhe metodës së Vereshqaginit.		
Qëllimet e lëndës:	Përgaditja e studentëve me qëllim të kalkulimeve të ndryshme të detajeve të konstruksioneve sipas kushteve të soliditetit, etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të bëjë analizën e sforcimeve dhe deformimeve në probleme të ndryshme në lëminë e inxhinierisë mekanike, pastaj, në konstruksione të ndryshme të eksponuara ndemjeve të nduarduarta, të bëjë dimensionimin e detajeve të ndryshme të atyre konstruksioneve dhe së fundi, të njeh metodat e ndryshme për zgjidhjen e sistemeve statikisht të papërcaktuar.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1/2	15	7,5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	4	8
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Total			182,5
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	60%		40%
Literatura bazë:	1. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve I, Prishtinë, 1994. 2. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve II, Prishtinë, 1994. 3. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve I-Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë, 1998. 4. Xh. Perjuci, Sh.Buza, Rezistenca e Materialeve II-Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë, 1998. 5. Xh. Perjuci, R. Likaj, Rezistenca e Materialeve -Manual, Prishtinë, 2002. 2. Hibbler R. C., Mechanics of Materials,2004.		

Titulli i lëndës:	KINEMATIKË		
Përshkrimi i lëndës	Hyrje në kinematikë. Kinematika e pikës. Kinematika e trupit të ngurtë. Rrotullimi i trupit të ngurtë rreth aksit të palëvizshëm. Lëvizja plane e trupit të ngurtë. Rrotullimi i trupit të ngurtë rreth pikës së palëvizshme. Lëvizja e përgjithshme e trupit të ngurtë. Lëvizja e përbërë e pikës. Lëvizja e përbërë e trupit të ngurtë.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmi Inxhinierisë mekanike- Kinematikës.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>A. Të gjejë trajektoren e pikës, shpejtësinë e pikës, shpejtimin e pikës nëse janë dhëne ligjet e lëvizjes në formë parametrike në koordinata të Dekartit, koordinata polare, koordinata cilindrike, koordinata sferike.</p> <p>B. Nëse lëvizja e pikës është dhëne në mënyrë natyrale me ligjin e lëvizjes sipas trajektore së dhënë, të gjejë shpejtësinë, shpejtimin tangjencial, shpejtimin normal dhe shpejtimin total të pikës.</p> <p>C. Të llogarisë shpejtësinë këndore dhe shpejtimin këndore të trupit që rrotullohet rreth aksit të palëvizshëm sipas ligjit të dhënë të rrotullimit trupit të trupit që rrotullohet rreth aksit të palëvizshëm sipas ligjit të dhënë të rrotullimit. Të dijë ti gjejë shpejtësinë dhe shpejtimin e pikave të trupit që rrotullohet rreth aksit të palëvizshëm sipas ligjit të dhënë të rrotullimit.</p> <p>D. Të llogarisë shpejtësitë dhe shpejtimet këndore të hallkave si dhe shpejtësitë dhe shpejtimet e pikave karakteristike të tyre, të një mekanizmi planar kur dihet ligji i lëvizjes së manivelës dhe pozita e mekanizmit.</p> <p>E. Gjatë lëvizjes së përbërë të pikës, kur dihet ligji i lëvizjes relative dhe asaj zhvendoseshë, të dijë të gjejë: a) shpejtësinë relative, shpejtësinë zhvendoseshë dhe shpejtësinë absolute të pikës, b) shpejtimin relativ, shpejtimin zhvendoseshë dhe shpejtimin absolut të pikës.</p> <p>F. Tek lëvizja e trupit rreth një pike të palëvizshme, sipas ekuacioneve të dhëna të lëvizjes me këndet e Euler-it të dijë ti gjejë shpejtësitë këndore dhe shpejtimit këndore të trupit dhe shpejtësitë dhe shpejtimet lineare të pikave të atij trupi.</p> <p>G. Ti zgjidhë dhe dorëzoi dy detyra seminarike, duke zbatuar programin aplikativ MathCAD ose Matematika 5 apo Matlab, i cili në këtë rast do të shërbejë për kontroll të rezultateve.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume dhe seminare.	2	4	8
Detyra të shtëpisë	4	13	52
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet ,etj	1	1	1
Total			167
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	40%		60%
Literatura bazë:	<p>[1]. Dr. sc. Th. Gace -Dr. sc. F. Krasniqi : Kinematika -Ligjërata të autorizuara, Prishtinë/Tiranë.</p> <p>[2]. Dr. sc. F. Krasniqi - Dr. sc. A. Shala : Kinematika - Përmbledhje detyrash (seminarike), Prishtinë.</p> <p>[3]. Dr. sc. F. Krasniqi: Kinematika - Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë.</p> <p>[4]. Dr. sc. F. Jagxhiu : Mekanika pjesa II/Kinematika, Prishtinë.</p> <p>[5]. Dr. sc. F. Krasniqi- Dr. sc. A. Shala: Kinematika/Përmbledhje e detyrave të zgjidhura dhe aplikimi i softuerëve MathCAD në zgjidhjen e tyre, Prishtinë.</p> <p>[6]. Dr.sc. F. Krasniqi: Përmbledhje detyrash me rezultate në Kinematikë, Prishtinë.</p>		

Titulli i lëndës:	SHKRIMI AKADEMIK		
Përshkrimi i lëndës	Njohja e studentëve me leximin akademik, shkrimin akademik dhe format tjera të raporteve si dhe prezantimi i punimit. Majerja që shtjellohet në këtë kurs paraqet bazën për njohuritë e gjuhës shqipe, rregullat gramatikore dhe shkrimin akademik.		
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmi e gjuhës shqipe dhe shkrimit akademik.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohja, aftësimi dhe aplikimi i njohurive të arritura në këtë kurs për prezantimin e ideve në forme të shkruara dhe përmes posterave.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiime,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	3	9
Projektet,prezantimet ,etj	2	3	6
Total			128
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, punime seminarike, teste, diskutime.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa praktike (%)</i>
	100%		0%
Literatura bazë:	[1] Dr. sc. Januz Dervodeli, Shkrim akademik, Gjilan, 2007, [2] Elona Boce, Si të shkruajmë një punim kërkimor, Qendra për arsim demokratik, Tirane, 2004 [3] Sylvan Barnett, Pat Balanca, Marcia Stubbs, Shkrimi akademik, Tirane, 2008.		

Titulli i lëndës:	GJUHE ANGLEZE II		
Përshkrimi i lëndës	Gjuhë angleze-gjuhë e huaj. Temat që trajtohen gjatë vitit u ndihmojnë dhe i favorizojnë studentet që të mësojnë dhe të përdorin fjalorin profesional duke përvetësuar katër shkathtësitë themelore të anglishtes: të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit dhe të folurit, gjegjësisht të komunikuarit në një nivel që i përshtatet njohurive, aftësive dhe nivelit të tyre studimor. Mësimi i gjuhës angleze në këtë drejtim, nuk ka për qëllim që të mësohen lëndet inxhinjerie në gjuhën angleze, por të implikohet gjuha angleze në lëndë, duke mësuar fjalë, shprehje profesionale, të ndërlydhura me gramatikën adekuate që trajtohet në temë.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi specifik i kësaj lënde është që studentët e këtij profili edukativo-arsimor të arrijnë atë nivel të njohurive gjuhësore dhe të një vokabulari të tillë që do të ishte i nevojshëm për punën e tyre në të ardhmen si dhe për avancimin e aftësive të tyre studimore për specializime të mëtutjeshëm në fusha të ngjashme profesionale.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje: 1. Të përdorin fjalor dhe literaturë profesionale 2. Të shpjegojnë tema të fushës së tyre 3. Të identifikojnë shprehjet shkencore në njësinë mësimore 4. Të krahasojnë dhe 5. Të vlerësojnë temat që janë zhvilluar gjatë procesit mësimor.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	7	14
Përgatitja përfundimtare për provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	4	8
Projektet, prezantimet ,etj	2	2	4
Totali			117
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Kryesisht metoda komunikative- interaktive</i>		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa praktike (%)</i>
	50%		50%
Literatura bazë:	1. Sarah Cunningham, Peter Moor – Cutting Edge, Longman 2. Lindsay White, New Interchange– OUP 3. Liz &John Soars, Headway, Oxford University Press		

Titulli i lëndës:	GJUHË GJERMANE II		
Përshkrimi i lëndës	<p>Në lëndën <i>Gjuhë gjermane I</i> gjatë ligjëratave do të mësohen pjesë nga gramatika e gjuhës gjermane që janë në shërbim të komunikimit dhe që janë të lidhura ngushtë me temat që do të trajtohen gjatë semestrit. Temat që do të zhvillohen do të jenë kryesisht nga libri bazë i kësaj lënde “<i>Themen Aktuell I</i>“ leksionet 1-5.</p> <p>Gjatë ushtrimeve do të ushtrohen dhe do të zhvillohen sistematikisht katër shkathtësitë kryesore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, por edhe gramatika e fjalori (vokabulari) përmes temave të librit “<i>Themen Aktuell I</i>“. Ky libër është i ndarë në leksione të cilat janë të organizuara në mënyrë tematike. Temat janë të zgjedhura nga jeta e përditshme dhe përkojnë me interesimet e nxënësve fillestarë. Përmes këtyre temave thellohen njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese në komunikimin e përditshëm. Studentët mësojnë si të reagojnë në situata të ndryshme komunikative me njerëz, për profesionet e tyre, për nevojat themelore jetësore, etj. Për të ushtruar shkathtësinë e të dëgjuarit, gjatë ushtrimeve do të përdoren edhe CD-të me tema nga libri bazë.</p>		
